



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësit ligjor konform Ligjit për ndërmarrje publike 03/L-087, Ligjit nr. 04/L-111 Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-087 Për Ndërmarrje Publike dhe ne mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e Ndërmarrjes që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, Bordi i Drejtoreve ka aprovuar Statutin e Komisionit të Auditimit të Brendshëm

## STATUTIN E KOMISIONIT TË AUDITIMIT NË KEK

### KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1.

##### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë këtë kuptim:
  - 1.1. Komisioni i Auditimit – Komisioni i Auditimit të Brendshëm në KEK;
  - 1.2. Kryesuesi – Kryesuesi i Komisionit të Auditimit;
  - 1.3. Njësia e Auditimit – Njësia e Auditimit të Brendshëm në KEK;
  - 1.4. ME – Ministria e Ekonomisë;
  - 1.5. Ministri – Ministri/ja e Ekonomisë;

#### Neni 2

##### Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohet përbërja, autoriteti, detyrat, përgjegjësit, thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve, si dhe raportimi i Komisionit të Auditimit në KEK.

#### Neni 3

## **Fushëveprimi**

Fushëveprimi Statuti zbatohet nga Anëtarët e Komisionit të Auditimit, Njësia e Auditimit,.

### **KAPITULLI II -- KOMISIONI I AUDITIMIT**

#### **Neni 4**

1. Komitetet e Auditimit krijohen nga menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik si në: Kuvendin e Kosovës, Presidencë, Kryeministri, Ministri dhe Komuna. Mënyra e funksionimit të komiteteve të auditimit, rregullohet me Udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në pajtueshmëri me praktikat dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
2. Komisioni i Auditimit themelohet me vendim të Ministrit dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë përfshirë edhe kryesuesin.
3. Mandati i Komisionit të Auditimit është i lidhur me mandatin e Bordit të Drejtorëve dhe rregullohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike
4. KA themelohet për të ndihmuar Korporaten në përmbushjen e përgjegjësive të saj për sa i përket menaxhimit të rrezikut të institucionit, kontrolleve, qeverisjes dhe aktiviteteve të ndërlidhura me to, si vijon:
  - Raportimit financiar dhe integritetit të pasqyrave vjetore financiare;
  - Pajtueshmërisë me ligjet, rregullat dhe Kodin e Etikës;
  - Funksionimit të kontrollit të brendshëm;
  - Menaxhimit të rrezikut;
  - Efikasitetit dhe objektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm (AB); dhe
  - Performancës së funksionit të AB-së dhe auditorëve të jashtëm (AJ).

#### **Neni 5**

##### **Pavarësia**

1. Kryesuesi dhe Anëtarët e Komisionit të Auditimit janë të pavarur në punën e tyre dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Asnjë person nuk mund të ushtrojë ose tentoj të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në Komisionin e Auditimit.

#### **Neni 6**

## **Kryesuesi dhe Anëtarët e Komisionit të Auditimit**

1. Kryesuesi dhe Anëtarët e Komisionit të Auditimit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Anëtari i Komisionit të Auditimit ka të drejtë që nëpërmjet Kryesuesit të kërkojë çdo informacion për veprimtarinë e Komisionit të Auditimit.

### **Neni 7**

#### **Dorëheqja**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit mund të japin dorëheqje nga Komisioni i Auditimit.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit e njoftojnë Ministrin për dorëheqjen e ofruar.
3. Anëtari që jep dorëheqje duhet të kryej të gjitha detyrat deri në caktimin e anëtarit të ri nga Ministri.

### **Neni 8**

#### **Shkarkimi**

1. Ministri me Vendim mund t'i shkarkojë Kryesuesin dhe anëtarët/ Anëtari i Komisionit të Auditimit vetëm nëse:
  - 1.1. Është dënuar për vepër penale nga Gjykata Kompetente;
  - 1.2. Kërkohet nga Komisioni i Auditimit që të bëjë shkarkimin;
  - 1.3. Keqpërdor dhe/apo neglizhon pozitën e tij si anëtar i Komisionit të Auditimit;
  - 1.4. Nuk merr pjesë pa arsye në tri (3) herë radhazi në mbledhje të Komisionit të
  - 1.5. Apo për arsye të tjera për të cilat Ministri Kompetent vlerëson se janë plotësuar kushtet për zëvendësim të Anëtarit gjatë mandatit të tij/saj.
  - 1.6. Në rastet e shkarkimit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit, Ministri cakton anëtarin apo anëtarët e rinj sipas të njëtës procedurë.

## **KAPITULLI III – AUTORITETI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KOMISIONIT TË AUDITIMIT**

### **Neni 9**

## **Autoriteti**

1. Komisioni i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të subjektit të

sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm, duke:

1.1. siguruar një mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit;

1.2. siguruar pavarësinë e Auditorit të Brendshëm;

1.3. vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;

1.4. siguruar që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;

1.5. këshilluar mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm

## **Neni 10**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Komisioni i Auditimit ka për detyrë dhe përgjegjësi të:

1.1. Ofrojë këshilla në të gjitha fushat e përgjegjësisë së menaxhmentit për Kontrollin e Brendshëm të Financave në KEK;

1.2. Sigurojë që menaxhmenti i KEK-ut, realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore në fuqi;

1.3. Rishikojë dhe aprovojë por jo drejtoj strategjinë e auditimit dhe planet vjetore të Njesisë së Auditimit;

1.4. Rishikoj raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet që dalin, si dhe të kërkoj siguri se Menaxhmenti i KEK-ut i ka adresuar këto si duhet;

1.5. Rishikoj deklaratat financiare, opinionin e auditimit të jashtëm dhe raportet;

1.6. Rishikoj përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ngritura nga auditimi i jashtëm;

1.7. Siguroj se ekziston një marrëdhënie efektive në mes të menaxhmentit, Njesisë së Auditimit dhe Auditorit të jashtëm;

1.8. Mbroj pavarësinë funksionale të Njesisë së Auditimit;

1.9. Vlerësoj përshtatshmërinë e burimeve të auditimit të brendshëm;

1.10. Siguroj që mashtrimi potencial ose korrupsioni i dyshuar i identifikuar në raportin e auditimit ose nëse Komisioni i Auditimit, është vënë në dijeni për këtë në ndonjë mënyrë tjetër, raportohen tek autoritetet kompetente;

1.11. Këshilloj mbi çështjet lidhur me rreziqet e identifikuara dhe sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në KEK;

1.12. Mbaj të dhëna për të gjitha mbledhjet së bashku me raportet e ofruara nga funksioni i auditimit të brendshëm, dhe të gjitha të dhënat e shkruara për të gjitha çështjet dhe dëshmitë që lidhen me këto raporte si dhe veprimet që merren nga Komisioni i Auditimit;

1.13. Ofroj qasje të plotë dhe të papenguar në të gjitha të dhënat ose raportet e përgatitura apo të mirëmbajtura nga Komisioni i Auditimit, me kërkesë të auditorit gjeneral ose autoritetit publik që ka funksione hetuese ose kontrolluese; dhe

1.14 Detyra të tjera të përcaktuara me Ligjin për NP-të dhe ligje dhe rregulla të tjera të aplikueshme, përfshirë standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira profesionale

## **APITULLI IV – MBLEDHJET DHE RAPORTIMI I KOMISIONIT TË AUDITIMIT**

### **Neni 11**

#### **Mbledhjet e Komisionit të Auditimit**

1. Komisioni i Auditimit mbanë së paku katër (4) mbledhje në vit.
2. Mbledhjet e Komisionit të Auditimit ftohen nga Kryesuesi.
3. Drejtori i Njesisë së Auditimit ftohet në të gjitha mbledhjet e Komisionit të Auditimit.
4. Kryesuesi mund të thërras mbledhje shtesë sipas nevojës.
5. Ministri, mund të kërkojë mbajtjen e mbledhjeve të tjera për të diskutuar çështje të caktuara, për të cilat kërkojnë këshilla nga Komisioni i Auditimit.
6. Komisioni i Auditimit me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij, në mbledhje mund të ftojë edhe zyrtarët e KEK-ut për të diskutuar çështjet e auditimit të brendshëm.
7. Kur kërkohen informata shtesë, Komisioni i Auditimit mund të ftojë persona tjerë të kualifikuar, brenda ose jashtë KEK-ut, për të ofruar përvojën e tyre sipas nevojës.
8. Mbledhja e Komisionit të Auditimit, është e vlefshme kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve.
9. Në rastet kur Komisioni i Auditimit vlerëson mund të kufizoj pjesëmarrjen e personave tjerë në takim dhe të zhvillojë takime në përbërje vetëm të Komisionit.

## Neni 12

### Procesverbali i mbledhjes

1. Për çdo mbledhje të Komisionit të Auditimit mbahet procesverbal.
2. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan dhe konkluzionet e arritura.

## Neni 13

### Raporti Vjetor

1. Komisioni i Auditimit, përgatit raportin vjetor, në të cilin përfshihet:
  - 1.1. Përbërja e Komisionit të Auditimit, detyrat dhe realizimi i tyre;
  - 1.2. Përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit të rreziqeve dhe rrugët për mënjanimin e tyre;
  - 1.3. Gjendja financiare dhe përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportues të KEK; 1.4. Pavarësia e Auditorit të Brendshëm dhe efektiviteti i Njesisë së Auditimit;
  - 1.5. Përshtatshmëria e ambientit të kontrollit të brendshëm për të siguruar operacione efektive, efikase dhe të ligjshme;
  - 1.6. Efikasiteti i Njesisë së Auditimit në rishikimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve të vlefshme për menaxhmentin e lartë, për përmirësimin e tyre.
  - 1.7. Ndonjë mangësi të madhe të sistemit, e cila rrezikon KEK-un; 2. Raporti vjetor i dërgohet Ministrit, më së largu deri me 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.
  - 1.8. Komisioni i auditimit duhet që për një periudhë prej së paku shtatë (7) vjetësh të mirëmbajë shënime për të gjitha procedimet e tij bashkë me të gjitha raportet e ofruara nga auditimi i brendshëm sikur edhe shënime gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet dhe dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha veprimet e ndërmarra nga Komisioni i Auditimit si përgjigje në ato raporte

## Neni 14

### Kërkesat për informacione

Më qëllim të përmbushjes se obligimeve të tij, Komisionit duhet t'i ofrohet në baza të rregullta kohore (në përputhje me afatet e raportimeve të Menaxhmenti përkatës) dhe sipas kërkesës së Komisionit informacioni në lidhje më çështjet në vijim:

- a) Raporti mbi vlerësimin e rrezikut në nivel të institucionit nga Menaxhmenti i KEK-ut;
- b) Raporti mbi progresin nga ZAB që përmbledhë:
  - Punën e kryer krahasuar me punën e planifikuar;

- Çështjet kyçe që dalin nga puna e auditimit të brendshëm;
  - Përgjigjja e Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të auditimit;
  - Ndryshimet e ndodhura në raport me Planin Vjetor të Auditimit;
- c) Ndonjë burim, fushë apo vlerësim i çështjeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit;
- d) Raporti mbi progresin nga Auditimi i Jashtëm;
- e) Plani strategjik mbi Auditimin e Brendshëm;
- f) Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm;
- g) Raportet dhe opinionet nga ZAB;
- h) Raportet për sigurimin e cilësisë, për sa i përket funksionit të AB-së;
- i) Draft pasqyrat financiare dhe shënimet nga Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar;
- j) Raportet mbi çfarëdo ndryshimi në politikën e llogaridhënies;
- k) Letrën për Mënaxhmentin nga Auditorët e jashtëm;
- l) Informatë në lidhje me bashkëpunimin në mes të Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të jashtëm; dhe
- m) Informata të tjera që Komisioni mund të kërkoj dhe që janë brenda funksionit dhe përgjegjësive të tij.

## **KAPITULLI V - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 15

### **Buxheti dhe Kompensimi**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit gëzojnë të drejtën e kompensimit në pajtim me vendimin nr 07/81 dt 23/03/2016 apo vendimet tjera nga ana e organit kompetent Qeveria e Kosovës për këtë qëllim dhe dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike , për angazhimin dhe punën e tyre në Komision.
2. KEK-u siguron buxhetin e nevojshëm, për punën, angazhimin, pjesëmarrjen në mbledhje si dhe funksionimin e përgjithshëm të Komisionit të Auditimit.

## Neni 16

Bashkëpunimi dhe Mbështetja e Komisionit të Auditimit të gjitha njësitë e KEK-ut obligohen që të bashkëpunojnë dhe t'i ofrojnë mbështetje Komisionit të Auditimit, për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

## Neni 17

Rishikimi i Statutit: Rishikimi i këtij Statuti, duke përfshirë edhe ndryshim plotësimin e tij, bëhet në mënyrën e njëjtë të miratimit të tij dhe sipas nevojës në pajtim me ndryshimet ligjore.

## Neni 18

Dispozitat e këtij statuti duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në veçanti Ligjin për ndërmarrje Publike, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative dhe ligjet tjera si dhe në rast të mospajtimeve eventuale, mbizotërojnë këto të fundit.

## Neni 19

### Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreshëve në KEK-sha

*Prezantë Dikana*  
*Prezantë Dikana*

